

SEE
MORE
Media Observatory Report

Numri i parë i MORE përmban:

1. **Vizita e Ministrit të Jashtëm grek në Tiranë, në maj 2022: Mediat humbin thelbin**
Faqe 5
2. **Media shqiptare e fiksuar pas çështjes së kufijve detarë**
Faqe 14
3. **Media greke e fiksuar pas marrëdhënieve Turqi-Shqipëri**
Faqe 21
4. **Integrimi i Shqipërisë në BE: mediat në të dy vendet humbasin rëndësinë politike të çështjes**
Faqe 26
5. **Shoqëria tregon rrugën: Historia e suksesit të Elina Tzengko**
Faqe 30

#01. Shkurt 2023

ZBATUAR NGA

MUNDËSUAR NGA

MBI

SEE MORE:



Prezantimi i Raportit të Observatorit të Medias (MORE)

Raporti i Observatorit të Medias (MORE) është pjesë e një projekti shumëdimensional [ALGREE — Albania-Greece: Understanding. Connecting. Partnering.](#) (Projekti ALGREE—Shqipëri-Greqi: Mirëkuptimi. Lidhja. Partneriteti.) i zbatuar nga [Programi i Evropës Juglindore të Fondacionit Helen për Politikën e Jashtme dhe Evropiane \(ELIAMEP\)](#), dhe mundësuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Fondacioni Friedrich Naumann për Lirinë e Greqisë dhe Qipros (FNF).

Çfarë do të thotë të quhesh fqinj? Të jesh fqinj do të thotë marrëdhënie që janë më tepër se të detyrueshme; të nevojshme. Marrëdhëniet mes dy vendeve fqinje kushtëzohen nga besimi, ose mungesa e tij, por edhe nga perceptimi që popujt kanë për njëri-tjetrin; këta të fundit ndikohen pjesërisht, por fuqishëm nga media dhe shkrimet e tyre.

Raporti i Observatorit të Medias (MORE), ka për qëllim të nxisë reflektimin në mediat në Greqi dhe Shqipëri, në mënyrë që ato jo vetëm të prodhojnë narrativa kritike mbi mënyrën se si dy qeveritë trajtojnë çështjet e pazgjidhura, por të japin edhe një shpjegim të balancuar të ndjeshmërisë së palës tjetër, duke mundësuar zhvillimin e **mirëkuptimit** mes dy popujve. Nëse media do të mund të promovonte një dialog të ndershëm, duke krijuar **një lidhje** mes dy shoqërive tona dhe duke mundësuar **partneritetin** e mirëfilltë mes dy vendeve tona, ndoshta ato do të mund të kapërcenin të kaluarën e tyre të

dhembshme dhe të zgjidhnin më në fund problematikat e trashëguara nga historia.

MORE nuk ka për qëllim të ofrojë një tjetër studim mbi mënyrën se si mediat në të dy vendet raportojnë për çështjet e njohura dhe të pazgjidhura. Ne, në fakt, synojmë të ofrojmë raporte të përmbledhur dhe lehtësisht të kuptueshëm mbi mënyrat se si media zgjedh të ushqejë axhendën publike me keqkuptime, mosbesim dhe narrativa negative.

Për këtë qëllim, MORE synon të ofrojë tema me vlerë si dhe stimuj për gazetarët, opinionistët dhe publicistët, për të reflektuar mbi mundësitë e humbura në sferën publike të të dy vendeve; publikimi ynë synon të inkurajojë mediat në të dy vendet, që të bëhen 'përkrahës' dhe të ndihmojnë në krijimin e një marrëdhënieje të re, dinamike dhe besimi midis dy vendeve: një partneritet i fortë në rajon dhe brenda Bashkimit Evropian.

Me fjalë të tjera, MORE nuk ka qëllim të drejtojë gishtin drejt keqbërjeve apo të kërkojë llogari nga media për të gjitha pasaktësitë, paragjykimet dhe stereotipet që ende mbizotërojnë në axhendën publike të të dy vendeve. Në vend të kësaj, ne dëshirojmë të paraqesim një vlerësim të balancuar të asaj që është raportuar; çfarë është lënë jashtë qëllimisht ose jo; dhe çfarë keqinterpretohet, theksohet apo jo. Ne kërkojmë të japim fakte të vërteta, të vlerësojmë rëndësinë politike të rolit të medias në ndikimin e diskursit publik, dhe të analizojmë shkallën në të cilën ajo ndikon në opinionin publik në të dy vendet.

Përpjekjet tona shtyhen nga bindja se, të gjitha marrëdhëniet shtet me shtet dhe shoqëri me shoqëri në Ballkan, kanë potencialin të zhvillohen si lidhje bashkëpunuese, progresive dhe largpamëse. Që të ndodhë kjo, të kuptuarit e ndjeshmërisë së njëri-tjetrit, shmangia e stereotipeve dhe keqkuptimeve dhe, përfundi-

misht, ndërtimi i urave dhe marrëdhënieve të besimit, duhet të jenë në rend të ditës. Greqia dhe Shqipëria mund t'u tregojnë fqinjëve të tjerë ballkanikë se si bëhet kjo në kontekstin e integritit të të gjithë rajonit në Evropë.

ÇFARË

SEE MORE:



Çfarë rrezikohet?

Trazirat e pa precedentë gjeopolitike të shkaktuara nga pushtimi rus dhe kthimi i luftës në Evropë, na kujtojnë zymtësisht luftërat jugosllave të viteve 1990. Vite lufte dhe vuajtjesh, rrënimi demokratik dhe ekonomik, që e mbajtën rajonin e Ballkanit në harresë ekonomike dhe politike, ndërsa pjesa tjetër e Evropës bëri përparime të mëdha, duke u ringjallur, demokratizuar, zhvilluar e integruar.

Përfaqësuesit e elitave politike dhe shoqërisë civile në të gjithë rajonin e Ballkanit, e kanë kuptuar se nuk ka më kohë për të humbur. Ballkani Perëndimor, i cili është dukshëm i lënë jashtë procesit të integritit evropian, duhet të ecë shpejt dhe të zgjidhë mosmarrëveshjet dypalëshe, të kapërcejë kontradiktat e së shkuarës që i mban shoqëritë e tyre të ndara, të reformojë institucionet problematike dhe të orientohet plotësisht drejt BE-së. Shtetet fqinje të Ballkanit, si Greqia, e dinë mirë se rreziku është i lartë për të gjithë rajonin. Rrjedhimisht, ata janë të vendosur të kontribuojnë në integritimin e shpejtë të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Meqë kanë kaluar më shumë se tridhjetë vite që nga fillimi i luftërave jugosllave, rajoni nuk mund të humbasë më dekada i mbërthyer në harresën politiko-ekonomike.

Në këtë moment kritik dhe të paqëndrueshëm, qeveritë e Shqipërisë dhe Greqisë, duket se kanë bërë një zgjedhje strategjike për të çuar përpara zgjidhjen e çështjeve të tyre të pazgjidhura dypalëshe; ato kanë vendosur të ndërtojnë një marrëdhënie të re, dinamike, që do t'i përmirësojë ato nga thjesht aleatë të NATO-s, në partnerë të vërtetë dhe, përfundimisht, së bashku në Bashkimin Evropian. Një partneritet i suksesshëm midis Athinës dhe Tiranës, mund të shënojë fillimin e një "momenti të ri evropian" për rajonin në të njëjtën mënyrë që, gati pesë vjet më parë, Marrëveshja e Prespës sinjalizoi gatishmërinë e Shkupit dhe Athinës, për të lënë pas vetes grindjet e tyre të hidhura dhe për t'i treguar pjesës tjetër të rajonit, rrugën drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Por për këtë qëllim, në partneritetin e ri në zhvillim mes Greqisë dhe Shqipërisë, niveli politik dhe ai shoqëror, duhet të ecin paralelisht. Një pjesë e mendimit që mbështet Raportin e Media Observatory (MORE) është se, mediat e të dy palëve deri më tani, nuk kanë arritur të përmbushin nevojën politike dhe shoqërore për marrëdhënie të mira midis dy vendeve. Në kundërshtim me situatën që po përmirësohet me shpejtësi në nivelin e politikës zyrtare dhe lidhjet shoqërore që ekzistojnë, mediat vazhdojnë të drejtohen nga keqkuptime dhe paragjykime. Ato vazhdojnë të humbasin mundësitë e ofruara nga dy qeveritë për të krijuar një hapësirë për raportim më të shëndetshëm dhe debat politik. Dhe, siç është bërë e qartë grafikisht në Raportin tonë të Media Observatory, vetë raportimi problematik, ndikon dhe formëson qëndrimet e opinionit publik, të cilat, nga ana tjetër, bëhen pengesë për mirëkuptimin politik dhe shoqëror ndërkuftar.

01.



SEE MORE:

Në brendësi të ngjarjeve

Çështja e parë e MORE, është rezultat i monitorimit që u zhvillua midis muajit **maj** dhe **shtator 2022**. Ne kemi përzgjedhur një sërë ngjarjesh kyçe nga kjo periudhë për t'i analizuar.

Për çdo ngjarje, Raporti i Media Observatory ofron:

- a. një historik të shkurtër
- b. një analizë të shkurtër cilësore të disa lajmeve të caktuara mediatike (shembuj ngacmues, tituj lajmesh, narrativa)
- c. një raport të ngjarjeve reale të raportuara në mënyrë jokorrekte; e përveç kësaj, trajtim alternativ të mundshëm
- d. një vlerësim të rëndësisë politike të zgjedhjeve të mësipërme mediatike dhe efektit të tyre në konceptimet publike, por më së shumti mundësive që media humbi për të luajtur një rol konstruktiv në krijimin e një debati politik më të shëndetshëm
- e. konkluzione kryesore përballë ndikimit politik dhe shoqëror të mbulimit mediatik.



Numri i parë i MORE përmban:

1. **Vizita e Ministrit të Jashtëm grek në Tiranë, në maj 2022: Mediat humbin thelbin**
[Shkoni në faqen 5](#)
2. **Media shqiptare e fiksuar pas çështjes së kufijve detarë**
[Shkoni në faqen 14](#)
3. **Media greke e fiksuar pas marrëdhënieve Turqi-Shqipëri**
[Shkoni në faqen 21](#)
4. **Integrimi i Shqipërisë në BE: mediat në të dy vendet humbasin rëndësinë politike të çështjes**
[Shkoni në faqen 26](#)
5. **Shoqëria tregon rrugën: Historia e suksesit të Elina Tzengko**
[Shkoni në faqen 30](#)

1. ÇËSHITJA

Vizita e Dendias

Vizita e Ministrit të Jashtëm grek në Tiranë, në maj 2022:
Mediat humbin thelbin



Skicë ilustruese (ID3090326,
©Stavros Damos - Dreamstime.com)

1.1. HISTORIK I SHKURTËR

Vizitat zyrtare mes dy vendeve tërheqin vëmendje të madhe mediatike. Nga ana greke, është ndoshta një nga rastet e rralla kur mediat shfaqin lajme me fokus Shqipëri. E kundërta ndodh në Shqipëri, lajmet për Greqinë janë më të shpeshta; megjithatë, vizitat e rralla zyrtare, ende tentojnë të tërheqin mbulim të konsiderueshëm mediatik, ndërkohë që pritshmëritë për rezultatin e vizitave të tilla janë zakonisht të larta.

Për Ministrin e Jashtëm grek, Nikos Dendias, vizita në Tiranë më 23 maj 2022, ishte e treta vizitë e këtij lloji në Shqipëri. Ishte takimi i parë me homologen e tij të re, Olta Xhaçka. Vizita e Dendias [ishte pjesë e një turi](#) në Ballkanin Perëndimor që synonte "një rikujtesë të rëndësisë që rajoni ka në BE" (TA NEA, 23 maj 2022), përpara Samitit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), i planifikuar për në Selanik më qershor 2022.

1.2. MEDIAT GREKE

Një konferencë shtypi “turbulluese”: Konferenca e parë e përbashkët për shtyp e dhënë nga dy ministrat, nuk përfundoi mirë, sipas mediave greke. Shumica e titujve kryesorë u përqendruan te “çështja çame” e ngritur nga ministrja shqiptare dhe reagimi i homologut të saj grek, në vend që të theksonin mesazhet e këtij të fundit në mbështetje të “ofertës” evropiane të Shqipërisë dhe për zgjidhjen e çështjes së kufijve detarë.

Çështja që pala greke e konsideron joekzistuese, “Çamët”, sigurisht që ishte dukshëm e pranishme në lajmet mediatike të nesërmen e vizitës së Dendias. Konkluzioni kryesor nga faqet e para të 24 majit ishte se, konferenca për shtyp ishte “turbulluese”, me një shkëmbim armiqësor deklaratash për “çështjen çame” të iniciuar nga një Ministre e Jashtme “agresive” shqiptare, e cila mori “një përgjigje të ashpër” nga homologu i saj.

Një i jashtëm që do të vëzhgonte faqet e para dhe titujt në mediat greke më 24 maj, ndoshta do të arrinte në përfundimin se të dy vendet ishin armiq, marrëdhëniet e të cilëve sapo kishin rënë në një nivel të ri të ulët.

Për shembull, e përditshmja **Political**, fliste për **“Mashtrimin shqiptar”** (duke përdorur fjalën *μαμπεσιά*, në shqip *pabesi*); Titujt e tjerë tregues ishin: “Një Ministër i Jashtëm **agresiv** shqiptar” (**Kontra**), “**Provokim** i tepruar nga shqiptarët” (**Dimokratia**), “**Veto** kundër rrugëtimit evropian të Shqipërisë” (**Estia**). Shumica e raporteve u fokusuan në “çështjen çame” dhe disa nënkuptuan ose deklaruan qartë, duke cituar Dendias, se ishte një “pengesë” e mundshme për ofertën evropiane të Shqipërisë.

MEDIAT GREKE

Vizita e Dendias

maj 2022

FJALË “TOKSIKE”

“Mashtrimin shqiptar”
POLITICAL, (E QENDRËS)

**“Një Ministër i Jashtëm
agresiv shqiptar”**
KONTRA

**“Provokim i tepruar
nga shqiptarët”**
DIMOKRATIA, (E QENDRËS)

**“Veto kundër rrugëtimit
evropian të Shqipërisë”**
ESTIA

MEDIAT GREKE

Vizita e Dendias

maj 2022



Në **TA NEA** (e qendrës) shkruhej: *“Kthimi... i ‘çamëve’ nga Tirana”*. Edhe pse shkrimi nisi me qëllimin kryesor të turit të Dendias në rajon, domethënë “të sigurojë stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, duke ruajtur perspektivën e tyre evropiane”, ajo theksoi se gjatë vizitës së tij në Tiranë “nuk u shmangën çështje të mprehta, me Ministren e Jashtme të Shqipërisë, Olta Xhaçka, e cila ngriti çështjen e çamëve dhe pronave të tyre në Greqi; Dendias iu përgjigj sfidës pa hezitim”.

To VIMA (e qendrës) hamendësonte nëse *“Çështja çame po i frenon perspektivat evropiane të Tiranës?”* dhe nënvizonte se “Tirana e ngre gjithmonë çështjen çame në takimet greko-shqiptare. Për Athinën, megjithatë, një çështje e tillë nuk ekziston dhe, natyrisht, nuk diskutohet aspak. Përgjigjja e Ministrit të Jashtëm, tregoi shqetësimin e Athinës”.

Estia (e djathtë) i kërkoi qeverisë greke *“t’i vërë veton rrugëtimit të Shqipërisë në BE, nëse Tirana këmbëngul për [të ngritur] çështjen çame”*. Duke e keqinterpretuar deklaratën e Ministres së Jashtme shqiptare, ajo shkruante: “Shqipëria ngre çështjen e Çamërisë së bashku me zonat detare. Në fakt, Ministrja e Jashtme, Olta Xhaçka, e sheh si një shkëmbim për pranimin e kompromisit [për zonat detare]”. Raporti citonte gjithashtu deklaratën e Dendias, duke vënë në dukje se mesazhi i tij “ishte i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë. Nëse Shqipëria do të këmbëngulë duke ngritur çështjen çame dhe pretendime të tjera të paarsyeshme, Greqia do të vërë veton kundër hyrjes së saj në BE.

Proto Thema (e qendrës) në analizën e saj mbi arsyet *“Pse Tirana vazhdon të ngrejë çështjen joekzistuese çame”* komentoi se: “Deklaratat e Xhaçkës treguan se qeveria e Ramës vazhdon të përdorë çështjen joekzistuese çame për qëllime elektorale, por edhe për të ushtruar presion ndaj palës greke.”

MEDIAT GREKE

Vizita e Dendias

maj 2022

**“Kthimi...
i ‘çamëve’ nga Tirana”**
TA NEA (E QENDRËS)

**“Çështja çame po i frenon
perspektivat evropiane
të Tiranës?”**
TO VIMA (E QENDRËS)

**“t’i vërë veton rrugëtimit të
Shqipërisë në BE, nëse Tirana
këmbëngul për [të ngritur]
çështjen çame”**
ESTIA (E QENDRËS)

**“Pse Tirana vazhdon të ngrejë
çështjen joekzistuese çame”**
PROTO THEMA (E QENDRËS)

1.3. MEDIAT SHQIPTARE

“Prioritete të ndryshme dhe ‘presion’ nga Greqia”: Mediat shqiptare raportuan gjerësisht për vizitën e Dendias dhe deklaratat e bëra në konferencën e përbashkët për shtyp me Olta Xhaçkën. Ato mbuluan kryesisht deklaratat për “Çështjen çame”. Mediat shqiptare u befasuan nga ‘toni’ i shefit të diplomacisë greke, i cili e cilësoi këtë çështje joekzistuese dhe paralajmëroi për pasojat në axhendën e Shqipërisë në BE.

Versioni shqiptar i [Voice of America](#)/ dhe [Deutsche Welle](#) (neutrale), i konsideruan si kërcënim fjalët e Ministrit të Jashtëm grek: *“Ministri i jashtëm i Greqisë, Nikos Dendias, kërcënon Shqipërinë nëse ngrihet çështja çame.”*. [Lapsi.al](#) (media opozitare) gjithashtu raportoi: *“Mësimi nga takimi ‘miqësor’ Dendias-Xhaçka: Greqia na kërcënon edhe në mes të Tiranës”*. Sipas Zërit të Amerikës, autoritetet greke kanë refuzuar gjithmonë të diskutojnë çështjen çame në bisedimet dypalëshe, duke e konsideruar atë si joekzistuese. Megjithatë, pala shqiptare e kishte ngritur prej disa vitesh atë të paktën në nivel të Ministrit të Jashtëm. Me të njëjtin ton, media pranë opozitës ([Syri.net](#), [Lapsi.al](#), [Politiko.al](#)) citojnë: *‘Dendias kërcënon Shqipërinë nëse ngre çështjen çame’*.




Çështje të tjera, si shfuqizimi i ligjit të luftës, rru-ga e integritit të Shqipërisë në BE, bashkëpunimi ndërkombëtar (si p.sh.: Shqipëria mbështet kandidaturën e Greqisë në KSKB) dhe thellimi i bashkëpunimit dypalësh (kriza energjetike, minoriteti grek, njohja e pensioneve të shqiptarëve në Greqi), janë pasqyruar pozitivisht në të gjithë spektrin mediatik shqiptar, por janë mbuluar më pak.

Analisti mediatik, Lufti Dervishi, ka vënë në dukje dallimet në axhendat dhe prioritetet e dy ministrave në një postim të publikuar në rrjetet sociale të raportuar nga [Javanews.al](#). Axhenda e shefit të diplomacisë greke, bazohej në

çështje konkrete dhe ai i sugjeroi homologes së tij shqiptare që të flisnin më shumë për çështje konkrete sesa për çështje të mëdha. Analisti Enver Bytyçi shkroi në [Syri.net](#) se, Dendias erdhi për t’i bërë presion Tiranës për kufirin detar dhe çështjet çame, duke kërcënuar me veton kundër Shqipërisë në BE. I intervistuar për [Report TV](#), kryetari i Partisë Drejtësi, Integritim dhe Unitet (PDIU, që mbështet çështjen çame), Shpëtim Idrizi, e cilësoi vizitën të dështuar, pasi nuk dha asnjë rezultat, duke qenë se palët zgjodhën të prioritojnë çështje të ndryshme. Megjithatë, ai falënderoi Ministren e Jashtme shqiptare për ngritjen e çështjes çame.

MEDIAT SHQIPTARE

Vizita e Dendias
maj 2022



1.4. QARTËSIM I SITUATËS MBI FAKTE TË VËRTETA

Çfarë u tha konkretisht: Në fjalinë e saj të fundit, [Xhaçka tha](#): “Ne besojmë dhe shpresojmë që konstruktiviteti dhe vullneti i mirë për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme reciprokisht në një çështje kaq të vështirë sa ajo e hapësirave detare, mund të shërbejë si një shembull i qasjes konstruktive me të cilën vendet tona mike mund të fillojnë diskutimet edhe për çështje të tjera, sado të vështira që kemi trashëguar nga historia e nga periudha tragjike e Luftës së Dytë Botërore, siç është nevoja për të abroguar Ligjin e Luftës, apo çështja e të drejtave të pronësisë dhe të drejtave të njeriut të komunitetit çam”.

Nikos [Dendias u përgjigj](#) kështu: “Dua të jem i sinqertë me ju. Kjo do të thotë, të diskutohen çështje reale, çështje që pala greke i pranon si ekzistuese dhe jo çështje që pala greke i konsideron si joekzistuese. Dhe sigurisht, çdo përpjekje për të krijuar dhe diskutuar çështje joekzistuese, kam frikë, do të ketë pasoja në nivele të shumëfishta. Për shembull, Greqia do të duhet të ngrejë çështje që lidhen gjithashtu me procesin tuaj të anëtarësimit”.

Pas dyerve të mbyllura: Duke lexuar deklaratat e plota të dy ministrave, është e qartë se ata diskutuan çështje të ndryshme dypalëshe, si dhe të tjera që kanë të bëjnë me axhendën evropiane të Shqipërisë: përcaktimi i kufijve detarë, “gjendja e luftës”, çështja e pronave dhe të drejtat e minoritetit grek, si dhe çështja e pensioneve për shqiptarët që jetojnë në Greqi.

Prioritetet: Shkëmbimi për “Çështjen çame”, është i vogël në krahasim me deklaratat e gjata të ministrave për çështje të tjera. Në fakt duket se delegacioni grek ka dashur të fokusohet më shumë në çështjen e kufirit detar; ka një tregues të qartë të “këtyre prioritetëve” në video me fragmente nga deklaratat e tyre të postuara nga



Agjencia e Lajmeve të Athinës. Nëse delegacioni grek do të donte të vinte në pah përgjigjen e Dendias ndaj homologes së tij për çështjen çame, do të kishte zgjedhur ta përfshinte [atë në video](#), siç bënë pas një konference të turbullt për shtyp me homologun e tij turk në prill 2021.

1.5. RËNDËSIA POLITIKE

Shmangia e thelbit dhe humbja e një mundësie: Vëmendja që media greke i kushtoi vizitës së zotit Dendias, nuk zgjati shumë. Dhe me përjashtim të së përditshmes [Avgi](#) (e majtë), e cila i kushtoi disa paragrafë "Ballkanit të durueshëm dhe rrezikut të një zjarrvënieje" më 29 maj, mediat greke në tërësi humbën thelbin e vizitës së Dendias, e cila ishte për të vënë në pah rëndësinë e rajonit dhe, si rrjedhojë, të rolit të Greqisë në avancimin e perspektivës evropiane të Shqipërisë. Në vend të kësaj, shumica e shkrimeve nënkuptonin (disa prej tyre të shprehura qartë), se Greqia duhet të vërë "veton" kundër anëtarësimit evropian të Shqipërisë, nëse ajo ngre sërish "çështje që nuk ekzistojnë".

Por çfarë shkakton vërtet keqardhje, është se media greke humbi një mundësi tjetër për të vepruar si "përkrahëse" në përpjekjet e dukshme të dy qeverive mbi gjetjen e mënyrave për të zgjidhur çështjet e tyre të pazgjidhura dypalëshe, për të përmirësuar atmosferën politike dhe për të ndërtuar besimin. Në vend të kësaj, shumica e

lajmeve të tyre riprodhuan narrativat e zakonshme, fjalët dhe shprehjet toksike që shërbyen vetëm për të përkeqësuar më tej marrëdhëniet midis dy popujve. (Një rezultat "i matshëm" mund të vihet re në komentet në internet të lëna nga lexuesit poshtë shkrimit në [Proto Thema](#)).

Nga të dyja palët, mediat humbën mundësinë për të vënë në dukje një problem të rëndësishëm për komunitetin shqiptar në Greqi: çështjen e sigurimeve shoqërore, e cila është pranuar publikisht nga një zyrtar grek për herë të parë. Shumë pak vëmendje iu kushtua ligjit për "gjendjen e luftës" mes dy vendeve, një çështje me ndjeshmëri për shqiptarët, pavarësisht se Dendias pranoi edhe një herë nevojën "për ta shfuqizuar". Një sërë çështjesh të tjera, pa dyshim, u ngritën në deklaratat për shtyp të dy ministrave, ku mediat mund të ishin fokusuar në pasqyrimin e atmosferës pozitive të evidentuar gjatë takimit të dy politikanëve. Por edhe një herë, media preferoi të përqendrohej në një çështje 'thumbuese', e cila pa dyshim, do të krijonte shqetësim tek lexuesit e tyre: një çështje që nuk përputhej me qëndrimin optimist të treguar nga dy ministrat e jashtëm.

Edhe një herë, duket se mediat në të dy vendet, po reflektojnë prioritizimin e ndryshëm të çështjeve të pazgjidhura nga qeveritë e tyre përkatëse. Kjo shpjegon deri diku edhe perceptimet e ndryshme të ndjeshmërisë së dy popujve për çështje të caktuara, të cilat pasqyrohen edhe në sondazhe. Ishte momenti i duhur që mediat t'i kushtonin më shumë vëmendje ndjeshmërisë së palës tjetër dhe/ose t'ua shpjegonin ato shoqërive të tyre përkatëse. Zgjidhja përfundimtare e të gjitha këtyre çështjeve, do të kërkojë vullnet të konsiderueshëm politik, por edhe dialog të ndershëm mes dy shoqërive. Ky është një rol, të cilin mediat në të dy vendet, me siguri mund ta ndërmarrin ose ta përkrahin.

Key Takeaways**1.6. KONKLUZIONE KRYESORE**

- ↳ Greqia dhe Shqipëria po bëjnë përpjekje serioze për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe dhe për t'u fokusuar në zgjidhjen graduale të mosmarrëveshjeve dhe problemeve të tyre të ndryshme.
- ↳ Vazhdojnë të ekzistojnë çështje të mprehta dhe mosmarrëveshje. Mediat nga të dyja palët priren të përqendrohen shumë më tepër në polemika dhe çështje me ndjeshmëri, sesa tek gjendja aktuale e marrëdhënieve zyrtare midis dy palëve.
- ↳ Gjithashtu, duke u fokusuar pothuajse ekskluzivisht në mosmarrëveshjet dhe në prioritetet që perceptohen të jenë të ndryshme, media nuk po arrin të raportojë me saktësi konvergjenat e opinioneve dhe bashkëpunimit si dhe konsensusin e shfaqur nga të dy vendet përballë orientimit të gjeopolitikës së rajonit, i cili është vendimtar në kontekstin e luftës në Evropë.
- ↳ Mediat nga të dyja palët, po flakin tutje një mundësi për të paraqitur me saktësi stadin e përmirësuar të marrëdhënieve dhe vullnetin e mirë që është treguar nga të dyja qeveritë. Publiku në të dy vendet vazhdon të ushqehet me një këndvështrim të keqinterpretuar të marrëdhënieve aktuale dypalëshe greko-shqiptare nga mediat e tyre.





TË INTERVISTUARIT SHQIPTARË

Problemet që ndikojnë marrëdhëniet shqiptaro-greke, sipas shqiptarëve / greko-shqiptare, sipas grekëve



TË INTERVISTUARIT GREKË



2. ÇËSHTJA

Media shqiptare e fiksuar pas çështjes së kufijve detarë



2.1. HISTORIK I SHKURTËR

Mungesa e një marrëveshjeje për zonat detare midis Greqisë dhe Shqipërisë, ka qenë një burim i gjatë tensioni në vitet e fundit. Një marrëveshje dypalëshe për këtë çështje, u arrit në vitin 2009, por Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, e anuloi marrëveshjen një vit më vonë, pas një sfide ligjore nga Partia Socialiste e Edi Ramës, në atë kohë në opozitë. Marrëveshja e vitit 2009, u konsiderua gjerësisht në Greqi, si një triumf diplomatik. Më pas, vendimi i Gjykatës i vitit 2010, krijoi një klimë mosbesimi, duke dëshmuar një pengesë të madhe në marrëdhëniet dypalëshe.

Bisedimet dypalëshe filluan sërish pas një periudhe 'të akullit' me qeverinë e re greke të udhëhequr nga Kyriakos Mitsotakis. Pas një takimi midis Ministrit të Jashtëm grek Nikos Dendias dhe Kryeministrit shqiptar Edi Rama në Tiranë më 20 tetor 2020, [u njoftua](#) se të dy vendet do t'i drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për të zgjidhur mosmarrëveshjen mbi kufijtë e tyre detarë në detin Jon. Që mosmarrëveshja t'i referohet GjND-së, të dyja palët duhet të arrijnë një marrëveshje të veçantë (kompromis), që do të përcaktojë si kushtet e paraqitjes së tyre, ashtu edhe procedurën e ndjekur. Deri më sot asnjë qeveri nuk e ka bërë publike progresin e bërë në bisedimet përkatëse.

2.2. MEDIAT SHQIPTARE

Thirrje për kujdes dhe transparencë: Rikonfirmimi i angazhimit për t'ia referuar GjND-së caktimin e kufijve të zonave detare gjatë vizitës së Dendias në Tiranë në maj 2022, u mirëprit nga mediat, përfshirë edhe ato pranë opozitës.

Edhe pas vizitës, mediat vazhduan të raportonin për intervistat dhe deklaratat e bëra nga përfaqësuesit politikë të të dy vendeve për hapat e ardhshëm, që do të duhej të ndërmerreshin në adresim të çështjes, si dhe kritikën ndaj qeverisë nga opozita dhe analistë të ndryshëm. Udhëheqësit kryesorë të opozitës, Sali Berisha dhe ish-Presidenti Ilir Meta, kanë akuzuar vazhdimisht qeverinë për mungesë transparence dhe për lëshim terreni ndaj Greqisë, ndërsa analistë si ish-diplomati Shaban Murati, kanë kritikuar qeverinë për përpjekjet e saj për të arritur një mirëkuptim me Greqinë dhe këshilluan për 'vigjilencë' në negociatë, duke pasur parasysh ndikimin e rëndësishëm të Athinës mbi Tiranën.

Meta një pengesë? Klan TV (pro qeveritare), [raporton](#) më 27 maj gjatë një interviste (**Skai fm**), në të cilën Dendias tha se, procedura e paraqitjes në GjND, do të zhvillohej pas zgjedhjes së presidentit të ri shqiptar, dhe se Presidenti aktual, Ilir Meta, në detyrë deri më korrik 2022, nuk do t'i jepte autorizim Kryeministrit shqiptar.

Duke komentuar vizitën e Dendias, Ilir Meta mohoi të ketë penguar dorëzimin e marrëveshjes në GjND, duke e akuzuar Ramën se, nuk e ka mbajtur të informuar me zhvillimet përkatëse. [Shqiptarja.com](#) (pro qeveritare), kritikoi Metën se i është përgjigjur një interviste në mediat greke (duke lënë të kuptohet se i ka kushtuar shumë vëmendje kësaj medie), pa i kërkuar dikush ndonjë reagim.

Si [Shqiptarja.com](#) dhe [Panorama](#) raportuan një tjetër intervistë, që Ministri i Jashtëm grek dha në Naftemporiki më 18 qershor. I pyetur nëse mund

të ketë zhvillime të shpejta në lidhje me marrëveshjen detare pas zgjedhjes së presidentit të ri shqiptar, Dendias u përgjigj se Rama kishte një rol kyç në trajtimin e çështjes.

"A është zgjeruar Greqia 12 milje apo jo?" Balkan Web/News 24 dhe media të tjera [raportuan](#) intervistën (për Newsbomb.gr) në të cilën Dendias tha se Greqia është zgjeruar në mënyrë të njëanshme 12 milje në detin Jon dhe se nuk kishte asgjë për të diskutuar, përveç disa detajeve teknike që paktën do të çojnë në GjND.

[Lapsi.al](#) (opozitare), [Gazeta Dita](#), Top Channel (pro-qeveritare), dhe [Euronews Albania](#) raportuan mbi intervistën (duke cituar median greke), të cilën Kryeministri grek dha më 11 shtator në Pannairin Ndërkombëtar të Selanikut: *"Mitsotakis: Në Hagë me Shqipërinë, pasi të zgjerohet kufirin me 12 milje". Ai tha: "Dhe dua të referohem konkretisht se, edhe për përcaktimin e Zonës Ekskluzive Ekonomike, ka një marrëveshje paraprake që të shkojmë në Hagë, por vetëm pasi ne të kemi zgjeruar kufirin tonë detar me 12 milje".*

Tek **Shqiptarja.com** (pro qeveritare), një artikull nga [gazetari Ardit Rada](#) fajësoi mediat opozitare për përhapjen e dezinformatave në lidhje me zgjerimin e kufirit detar me 12 milje.

Platforma e verifikimit të fakteve **"Faktoje.al"** [raportoi](#) më 22 shtator se, shkrimet e publikuara në mediat shqiptare, ku thuhej se Greqia ka kërkuar zgjatjen e kufirit të saj detar "me 12 milje të tjera" nga deti shqiptar, ishin **të pavërteta**. Konkretisht, një artikull i botuar më 19 shtator në ["Gazeta Korrekte"](#), i cili fokusohet në deklaratat e Dendias me titull: *"Kërkojnë edhe 12 milje të tjera nga deti shqiptar / Mësohet se çështja me Greqinë shkon në Hagë"*. **Faktoje** zbuloi se titulli i artikullit e keqinterpretoi intervistën e dhënë nga Dendias në [gazetën greke "Parapolitika"](#) më 17 shtator, ku ai kujtoi [vendimin në vitin 2021 nga parlamenti grek](#) për të zgjeruar kufijtë e vendit nga 6 në 12 milje në detin Jon. **Faktoje** konfirmoi se nuk ka asnjë lidhje të

drejtpërdrejtë midis zgjerimit prej 12 miljesh të Greqisë në Detin Jon dhe referimit të Shqipërisë dhe çështjeve dypalëshe të Greqisë në GjND.

“Mos i besoni Greqisë”: Ish-diplomati Shaban Murati, ka shkruar shpesh për **Gazetën Dita** (pro qeveritare) për çështjen e kufirit detar. Në një [Opinion](#) të titulluar **“Lëshime të rënda strategjike, një pikë e errët e vizitës së Dendias në Tiranë, që u la kinse në heshtje”**, Murati shkruan ndër të tjera se diplomacia shqiptare, vuan nga një kompleks inferioriteti dhe se Rama po i fsheh publikut atë që po negociacion me Greqinë, nga frika se kjo do të bjerë në kundërshtim me vendimin e marrë nga Gjykata Kushtetuese. Për më tepër, Murati ka argumentuar se Shqipëria duhet të refuzojë të diskutojë për çështjen e minoritetit grek, derisa Greqia të ndalojë së mohuari ekzistencën e çështjes çame.

Tek shkruan te [Gazeta Dita](#) më 20 korrik (**“Kurthi grek në Kornizën Negociuese të BE- së për Shqipërinë”**), Murati argumenton se kuadri negociues për anëtarësimin në BE, e detyron Shqipërinë të gjejë zgjidhje për çdo mosmarrëveshje kufitare përpara se të anëtarësohet në BE. Për Muratin, kjo është Greqia që zbaton vullnetin e saj në rrugën e Shqipërisë drejt BE-së, duke i kthyer kështu kërkesat greke në kushte për anëtarësimin në BE.

MEDIAT SHQIPTARE


mbi kufijtë detarë



Meta trembet nga ministri grek Dendias dhe i jep llogari: "Nuk pengova unë çështjen e detit në Hagë! Kam dhënë çdo autorizim dhe mbështetje, por qeveria nuk më informonte"

Presidenti i Republikës Ilir Meta ka dalë në një konferencë për shtyp për t'u penguar ministrit grek Nikos Dendias pas një interviste që ai ka dhënë në shtyp grek pas vizitës në Shqipëri. Në mënyrë të habitshme, presidenti Meta i jep llogari ministrit grek për çështjen e Detit, duke u justifikuar se ai nuk ka penguar detyrimin e çështjes në Hagë.

■ Deti mes Greqisë dhe Shqipërisë në Hagë, Dendias për mediat greke: Po presim të ikë Meta, nuk ka dhënë autorizim



2.3. MEDIAT GREKE

Jo një çështje e diskursit publik: Media nuk u fokusua kurrë në rëndësinë e marrëveshjes fillestare për t'ia referuar çështjen GJND-së. Çështja nuk ka qenë mediatike apo publike, pasi asnjëherë nuk ka ngjallur reagime nga opozita. Pak artikuj kanë kërkuar të shpjegojnë se çfarë mund të sjellë zgjidhja e kësaj çështjeje të pazgjidhur për të dy vendet. Në përgjithësi, mediat e kanë prezantuar marrëveshjen e vitit 2020 me Shqipërinë, ashtu siç dëshiron qeveria greke të prezantohet: pra, si shembull i zgjidhjes së problemeve me fqinjët në bazë të së drejtës ndërkombëtare.


I pyetur në një intervistë për **"Parapolitika"** më 4 qershor, se kur do të nënshkruhet kompromisi me Shqipërinë, Dendias tha se të dyja palët ishin zotuar se do të shpejtonin procesin ligjor, por theksoi edhe një herë qëllimin përfundimtar dhe atë që Greqia do të dëshironte të përcillte: "Ne po japim një shembull të qartë për rajonin e gjerë se si duhet të zgjidhen mosmarrëveshjet. Gjithmonë përmes ligjit ndërkombëtar dhe ligjit të Detit, në veçanti."

Asnjë përparim: Qeveria greke nuk shpjegoi kurrë publikisht arsyet pse nuk u arrit asnjë progres thelbësor në bisedimet teknike për kompromisin për gati dy vjet e gjysmë pas marrëveshjes fillestare. Janë botuar disa artikuj, veçanërisht në gazetën e djathta opozitare **Estia** dhe **Dimokratia**, të cilat e paraqesin kundërshtimin e Presidentit të Shqipërisë, Meta, për këtë çështje, si pengesë kryesore.

Kultivimi i një klime dyshimi: Më 17 korrik, e përditshmja **Paron** (e majtë) botoi "Lojërat e Ramës: ai dëshiron të negociojë vetë me Greqinë", duke adoptuar retorikën e opozitës shqiptare. Për zgjedhjen e presidentit të ri shqiptar, gazeta riprodhoi narrativa që kultivojnë një klimë mosbesimi ndaj elitës politike shqiptare në përgjithësi dhe kryeministrit Rama në veçanti. Pas zgjedhjes së pre-

MEDIAT GREKE

mbi kufijtë detarë



sidentit të ri, Bajram Begaj, shkruhej se “Rreziqet për Shqipërinë janë të mëdha tani, pasi nuk ka më justifikime (...) Tani do të shohim nëse zoti Rama është vërtetë i sinqertë, apo thjesht ka dashur të vërë në gjumë Athinën dhe të sigurojë mbështetjen e saj për BE-në, kundrejt angazhimeve që ai nuk është i gatshëm t’i ndërmarë.”

Situatë e sikletshme: Në përgjithësi, mediat greke nuk raportojnë për reagimet dhe kritikën e brendshme ndaj Ramës për çështjen e kufirit detar. Kur në mediat shqiptare publikohen lajme për polemikat që sjell një zgjidhje e përbashkët e GJND-së në skenën politike në Tiranë, në mediat greke mund të dallohet njëfarë tensioni. Kjo, së bashku me mungesën e njohjes së thellë të realitetit politik shqiptar, bën që mediat greke zakonisht të ribotojnë artikuj pa komente të mëtejshme. Ky ishte rasti me shkrimin e Muratit për **Gazetën Dita** më 21 korrik. Uebsajtet e lajmeve, përfshirë in.gr, thjesht e përkthyen artikullin e tij me titullin: “Analiza shqiptare: kurthi grek në kuadrin e negociatave të BE-së për Shqipërinë”, pa ndonjë shpjegim të mëtejshëm të argumenteve të paraqitura nga ish-diplomati.

2.4. ALGREE: Mbulim alternativ

Raportim i balancuar: Brenda periudhës së monitorimit të medias, vetëm një opinion/analizë, në **TA NEA** më 30 korrik, bëri një raport të balancuar të rëndësisë së marrëveshjes 2020. Me titullin “*Delimitimi i kufijve detarë: Greqi-Shqipëri dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë*”, eksperti i së drejtës ndërkombëtare, profesor Petros Liacouras [shpjegoi në mënyrë të thjeshtë](#) por gjithëpërfshirëse, të mirat e të këqijat e çdo referimi në GJND. Ndër të tjera, Liacouras theksoi se “Çdo marrëveshje gjyqësore legjitimohet nga parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare që e mbështesin atë dhe e çojnë në një vendim përfundimtar dhe detyrues. Megjithatë, si rregull, jo gjithnjë të dyja palët dalin të fituara”.

Opinionet e analistëve janë të rëndësishme, sepse jo vetëm që shpjegojnë procesin ligjor në një mënyrë të lehtë për t'u kuptuar, por gjithashtu informojnë publikun dhe e përgatisin atë për rezultatin e mundshëm. Kjo duhej të ishte një pjesë integrale e strategjisë së politikës së jashtme të Greqisë përpara çdo zgjidhjeje ndërkombëtare dhe një detyrë nga ana e qeverive greke; fatkeqësisht, mbetet në dorën e vetëm disa akademikëve dhe analistëve, të cilët marrin përgjegjësinë për të shpjeguar proceset e ndërlikuara ndërkombëtare, pa ndonjë anshmëri të qartë pro-greke. Ka një mungesë të theksuar të analizave të paanshme mbi çështje të ngjashme në mediat greke.

Kështu ndodh edhe me palën shqiptare, ku shumë media përdorin gjysmëdeklarata apo lajme të pjesshme në raportet e tyre me një objektiv të vetëm: të shërbejnë si klikim. Rreziku i krijimit të një narrative alarmante për marrëdhëniet midis dy vendeve, të cilat më pas mund të keqpërdoren nga politikanët ose grupet e veçanta, është i lartë.



SONDAZH I OPINIONIT PUBLIK: OSFA/ELIAMEP, 2021
Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë

Çështja e Zonës Ekskluzive Ekonomike (ZEE) si një nga problemet që ndikon në marrëdhëniet Shqipëri-Greqi - Greqi-Shqipëri



30% 1.5%

e të anketuarve
shqiptarë

e të anketuarve
grekë

2.5. H RËNDËSIA POLITIKE

Perceptime të ndryshme - rëndësi unike: Vendimi dypalësh për t'iu drejtuar GJND-së, do të heqë një pengesë të madhe për vendosjen e një marrëdhëniejëmëtëshëndetshmemidisShqipërisë dhe Greqisë. Ajo që nuk shpjegohet plotësisht nga media, veçanërisht nga pala shqiptare, është se referimi në GJND, përfaqëson shansin më të mirë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, që sigurohet nëpërmjet një vendimi nga një organ ndërkombëtar neutral dhe legjitim. Vendosja e legjitimitetit dhe përshtatshmërisë së procesit gjyqësor ndërkombëtar në sytë e publikut, do të rrisë nivelin e besimit midis dy vendeve dhe shoqërive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për palën shqiptare, pasi kufijtë detarë, duket se janë më të rëndësishëm dhe marrin ngjyrim më emocional atje në nivelin e opinionit publik.

Në përgjithësi, mediat nga të dyja palët, priren ta mbulojnë çështjen me një prirje partiako-politike ose kombëtare, që shpesh çon në nxitjen e frikës së një publiku emocional. Por meqenëse asnjëra nga qeveritë nuk bën asnjë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e çështjes, ose për ta bërë publikun më të hapur ndaj rezultatit të vendimit të GJND-së, është e vështirë për mediat që ta luajnë këtë rol pa ndihmë.

Megjithatë, media mund të fokusohet në përfitimet e shumta të marrëdhënieve dypalëshe dhe rajonin e Ballkanit në tërësi; që do të thotë, media mund të theksojë rëndësinë gjeopolitike të zgjidhjes së çështjes, e cila do të dërgonte një mesazh të fortë për rajonin që të përpiqet të zgjidhë mosmarrëveshjet në një periudhë trazirash gjeopolitike. Media mund të theksojë gjithashtu se, zgjidhja e çështjes, është e rëndësishme për procesin e integritetit të rajonit në BE, duke pasur parasysh përfitimet që vijnë prej saj në drejtim të bashkëpunimit politik dhe ekonomik. Së fundi, media mund të nxisë të dyja qeveritë që të jenë më proaktive, transparente dhe vërtet të gatshme për të arritur një marrëveshje së shpejti.

2.6. KONKLUZIONE KRYESORE

- ↳ Shqipëria dhe Greqia kanë nisur një proces që do të zgjidhte një çështje kyç në listën e problemeve të tyre dypalëshe. Procedura gjyqësore ndërkombëtare, është procesi më i përshtatshëm dhe më legjitim, duke pasur parasysh edhe ngjyrimet emocionale që merr kjo çështje në të dyja shoqëritë.
- ↳ Natyra tejet teknike dhe komplekse e problemit, po shfrytëzohet nga disa media dhe analistë për të mbjellë mosmarrëveshje dhe për të dobësuar besimin mes dy palëve.
- ↳ Mediat shqiptare në veçanti, shpesh publikojnë gjysmë të vërteta, analiza dhe pretendime të pabazuara në lidhje me “qëllimet reale” të supozuara të Greqisë, duke kultivuar një narrativë se grekët po punojnë për të mashtruar Shqipërinë që ajo të pranojë një marrëveshje që po dëmton interesat e saj kombëtare.
- ↳ Dy qeveritë duhet të jenë më proaktive në shpjegimin e procesit dhe përfitimeve të tij, si dhe në edukimin e publikut.
- ↳ Media duhet të jetë më e kujdesshme dhe të kuptojë se çfarë është në rrezik për të dy vendet dhe për të gjithë rajonin, nëse humbet orientimin e saj gjeopolitik properëndimor.
- ↳ Qeveritë, ekspertët dhe mediat, duhet të punojnë së bashku për të përmirësuar diskursin publik dhe për të ndërtuar dhe konsoliduar një atmosferë besimi dypalësh.

3. ÇËSHTJA

Media greke e "fiksuar" pas marrëdhënieve Turqi-Shqipëri

**3.1. HISTORIK I SHKURTËR**

Për shumë vite, media greke ushqeu narrativën se, Turqia qëndronte pas vendimit të Edi Ramës për të kundërshtuar ligjërisht marrëveshjen e kufijve detarë të vitit 2009. Kjo narrativë u ushqye nga deklarata sporadike të anëtarëve të opozitës shqiptare, deklarata kontroverse të personazheve publike turke (por jo zyrtarëve) dhe zërave nacionalistë në Greqi.

Nuk ka asnjë provë që vendimi i Ramës të jetë diktuar në ndonjë mënyrë nga Ankaraja. Gjithashtu, mediat greke janë tipike dyshuese për takimet dypalëshe dhe marrëveshjet ushtarake mes Shqipërisë dhe Turqisë. Në përgjithësi, ato tentojnë ta portretizojnë Tiranën si një përfaqësuese të interesave turke në rajon dhe synimeve të saj "keqdashëse" përballë Athinës.

3.2. MEDIAT SHQIPTARE

“Midis miqësisë dhe qëndrimit kritik”: Gjatë periudhës së monitorimit, raportet e medias shqiptare për marrëdhëniet Shqipëri-Turqi, u fokusuan në çështje dypalëshe, pa përmendur në rendin e ditës çështjen e kufirit detar me Greqinë apo marrëdhënien e Ramës me Erdoganin. Ndërkohë mediat opozitare në veçanti, iu drejtuan me kritika qeverisë shqiptare për gjoja shkeljen e të drejtave të njeriut në ekstradimin e anëtarëve të opozitës turke me kërkesë të qartë të Erdoganit. Për më tepër, mediat shqiptare raportojnë rregullisht për tensionet mes Greqisë dhe Turqisë, por me ton neutral dhe pa mbajtur anën e askujt.

3.3. MEDIAT GREKE

Një “marrëdhënie dashurie”: Një shembull tipik se si mediat greke i interpretojnë marrëdhëniet mes Edi Ramës dhe Erdoganit të Turqisë, jepet nga artikulli me titull *“Dashuria (jo dhe aq) e papritur e Ramës me Erdoganin dhe flirti ‘i çuditshëm’”*, botuar në **Manifesto** (e djathtë) më 26 gusht: *“Përpjekjet e Ankarasë për të ndërhyrë në rajon, nuk janë sekret. Sidomos kur bëhet fjalë për Shqipërinë, gjithçka ka të bëjë me bisedimet me dyer të mbyllura dhe qëndrimin e Tiranës për çështjen e kufijve detarë ndaj Athinës. Greqia ra dakord 12 milje detare me Italinë, por Rama bëri një... driblim, duke zgjedhur opsionin e Gjykatës Kushtetuese për t’u shërbyer në thelb interesave të Turqisë”*.

Një takim “vëllazëror”: Më 9 gusht, Rama udhëtoi për në Turqi me ftesë të Erdoganit, për të marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së Lojërave të Solidaritetit Islamik. Rama postoi në Facebook, se do të kishte një *“takim vëllazëror”* me Erdoganin, për të diskutuar ecurinë e bashkëpunimit dypalësh. Duke marrë shkas nga fjalët e Ramës, mediat greke theksuan marrëdhënien e ngushtë

MEDIAT GREKE

Marrëdhëniet Turqi-Shqipëri



mes dy liderëve. Për mediat greke, fjalët e Ramës vërtetuan pikëpamjen që ata kishin tashmë: se dy liderët dhe vendet janë shumë afër. Mediat greke komentuan gjithashtu, se kryeministri shqiptar mori pjesë në “një shfaqje që synonte t’i jepte legjitimitet dhe njohje liderit turk qipriot, Ersin Tatar”. Mediat greke publikuan foto të Edi Ramës, i pranishëm, së bashku me zyrtarë të tjerë, në të njëjtën dhomë me liderin turk qipriot. Mediat e [quajtën](#) këtë si provë, që Rama e njihte autoritetin e udhëheqjes turke qipriote dhe po i jepte asaj legjitimitet.

“Shërbëtori i Erdoganit”: Faqja e parë e [Dimokratia](#) (e djathtë) më 26 korrik, mbante titullin “Attila (duke iu referuar pushtimit të Qipros nga Turqia në vitin 1974) ka mbështetjen e Ramës”, me nëntitullin “Shqipëria, shërbëtorja e Erdoganit, po provokon paturpësisht Greqinë: Kështu na shpërblejnë për mbështetjen tonë të pakushtëzuar në BE”. Artikulli citon mediat qipriote dhe një faqe greke ([slpress.gr](#)): “Pas përpjekjes së Ministres së Punëve të Jashtme të Shqipërisë për të ngritur çështjen çame dhe ngjarjeve të papranueshme në parlamentin shqiptar kur vendi ynë u akuzua për gjenocid, si dhe dhënie e marrje të vazhdueshme me Ankaranë, shqiptarët tani kanë akuzuar Republikën e Qipros për “izolim” e turqve qipriotë. Ky incident i pabesueshëm ndodhi në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të mërkurën e kaluar, më 20 korrik, kur përfaqësuesi i përhershëm i Shqipërisë në OKB, ngriti çështjen e të ashtuquajturit izolim të turqve qipriotë.

3.4. QARTËSIM I SITUATËS MBI FAKTE TË VËRTETA

Për takimin Rama-Erdogan: Publiku u njoftua për takimin e dy liderëve në fillim të gushtit përmes një postimi të kryeministrit shqiptar në Facebook, ku ai i referohej në mënyrë të paqartë progresit të bërë në projektet e përbashkëta pa i përmendur ato. Madje mediat shqiptare

Çështja #3 Marrëdhëniet Turqi-Shqipëri



Foto: P7GPMFD
© iLix48, Envato Elements
(përshtatje)

raportuan se takimi ishte acaruar kur Rama refuzoi në momentin që Erdogan kërkonte që Shqipëria të merrte masa kundër *gülenistëve*. Kjo nuk u përmend fare nga mediat greke, pasi nuk i shërben narrativës greke të Tiranës që nxit interesat e Ankarasë.

Ndërhyrja në OKB për Qipron: Debati në Kombet e Bashkuara u zhvillua më 20 korrik, me rastin e rinovimit të mandatit të Forcave Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në Qipro (UNFICYP) pas një raporti të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Për herë të parë, SHBA-të dhe Britania e Madhe, ngritën çështjen e izolimit ekonomik të turqve qipriotë, të cilët janë plotësisht të varur nga Ankaraja. Përfaqësuesi i përhershëm i Shqipërisë në OKB, thjesht u rreshtua me qëndrimet e Uashingtonit dhe Londrës, në vend që të përfitonte nga rasti për të nxitur një axhendë turke, siç e paraqisnin mediat greke Shqipërinë. Qartësisht, mediat greke nuk përmendën se nisma për të ngritur çështjen e qipriotëve turq erdhi nga amerikanët. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë se marrëdhëniet mes SHBA-së dhe Greqisë, janë aktualisht në nivelin më të mirë në dekada; kështu që mediat greke, fajësojnë Tiranën për një nismë që në fakt është bërë nga pushteti që Athina e sheh si aleatin e saj më të ngushtë në marrëdhëniet e vështira me Ankaranë. Së fundi, [formulimi përfundimtar](#) i dokumentit të OKB-së, u paraqit me tone më

të moderuara, duke përmendur thjesht nevojën për "të rikthyer izolimin e turqve qipriotë". Theksojmë këtu, se nuk pati asnjë reagim nga Nikosia.

3.5. RËNDËSIA POLITIKE

Deformimi i realitetit: Artikujt e mësipërm nuk janë të rrallë në raportimet e mediave greke për marrëdhëniet Turqi-Shqipëri. Janë shembuj goditës, por tipikë të tendencës nga ana e shumë mediave greke për të shtrembëruar realitetin politik dhe nivelin e marrëdhënieve diplomatike, politike dhe ekonomike midis Tiranës, Athinës dhe Ankarasë. Të përditshmet e krahut të djathtë si **Dimokratia**, mbulimin e së cilës e kemi parë më lart, shkëlqejnë në keqinterpretimin e marrëdhënieve zyrtare midis Shqipërisë dhe Turqisë. Thënë kështu, i gjithë spektri i shtypit grek, duke përfshirë të përditshmet tipike më pak nacionaliste të majta, priret të jetë i njëanshëm kundër qeverisë shqiptare, kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e saj me Turqinë.

Shumë media greke tentojnë ta përshkruajnë Shqipërinë si një pothuajse-armik që u shërben interesave "keqdashëse" të Ankarasë kundër Athinës në një mënyrë ose në një tjetër, pa pasur burime të besueshme apo prova të dokumentuara. Mediat greke thuajse kurrë nuk ofrojnë një analizë të arsyeshme e të mirinformuar të qëndrimeve të politikës së jashtme shqiptare dhe zakonisht ekzagjerojnë marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë. Për më tepër, ato pothuajse asnjëherë nuk analizojnë arsyet pse Shqipëria ndonjëherë mund të mbështetet më shumë tek Turqia për ndihmë, duke vënë rrallë në dukje mungesën e mbështetjes së ngjashme nga BE-ja apo Greqia. Në mungesë të mekanizmave të qartë mediaticë për të luftuar dezinformimin dhe gjuhën e urrejtjes në Greqi, raportet si më sipër, do të vazhdojnë të nxisin perceptime negative, narrativa dhe ide të shtrembëruara për

Shqipërinë dhe marrëdhëniet e saj me Greqinë dhe Turqinë. Për më tepër, keqinterpretimi i marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Turqisë nga mediat greke, është mundësuar gjithashtu edhe nga dështimi i qeverive dhe elitave politike në të dy vendet, për të ofruar bindje të mjaftueshme për qëllimet e njëri-tjetrit, si dhe nga dështimi i tyre për të punuar drejt ndërtimit të një besimi të ndërsjellë.



3.6. KONKLUZIONE KRYESORE

- ↳ Shqipëria dhe Turqia ruajnë marrëdhënie miqësore. Këto marrëdhënie kanë dinamikën dhe logjikën e tyre, të cilat mund të kuptohen, analizohen dhe shpjegohen, por jo domosdoshmërisht – ose, në të vërtetë, nuk ndikohen përgjithësisht nga marrëdhëniet midis Athinës dhe Tiranës, ose edhe nga marrëdhëniet e trazuara midis Athinës dhe Ankarasë.
- ↳ Fakti që nuk ka asgjë të jashtëzakonshme apo unike në marrëdhëniet Shqipëri-Turqi vërtetohet edhe nga gjetjet e sondazheve shqiptare.
- ↳ Megjithatë, mediat greke priren të mbitheksojnë lidhjen mes Tiranës dhe Ankarasë dhe ta keqinterpretojnë plotësisht Shqipërinë si një përfaqësuese të Turqisë në rajon. Nga ana tjetër, narrativa të tilla priren të minojnë çdo përpjekje të bërë për të ndërtuar besimin midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe për të ricikluar paragjykimet antishqiptare dhe stereotipet negative.
- ↳ Qeveritë në Shqipëri dhe Greqi janë gjithashtu pjesërisht përgjegjëse, duke pasur parasysh dështimin e tyre, si për t'i ofruar njëra-tjetrës siguri për qëllimet e tyre dhe për të ofruar mbështetje të mjaftueshme në përpjekjet për të ndërtuar besimin midis dy shoqërive.
- ↳ Ekziston një nevojë e madhe për iniciativa politike dhe mediatike për të ndryshuar paragjykimet e të menduarit mbi politikën e jashtme dhe raportimin mediatik.

4. ÇËSHTJA

Integrimi i Shqipërisë në BE: mediat në të dy vendet humbasin rëndësinë politike të çështjes



Resht karrigesh (ID140631848,
©Mikhail Mishchenko - Dreamstime.com)

4.1. HISTORIK I SHKURTËR

Pas shtyrjeve të shumta, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut më në fund filluan bisedimet e tyre të pranimit në BE më 18 korrik. Lajmi u mirëprit ngrohtësisht nga Athina si një zhvillim i rëndësishëm për politikën e saj të jashtme, e cila ka qenë mbështetëse e integrimit të Ballkanit Perëndimor në BE që nga viti 2003.

Zëvendësministri grek për Çështjet Evropiane, Miltiadis Varvitsiotis, duke marrë pjesë në Konferencën e parë Ndërqeveritare të BE-së me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, foli [për këtë ditë të rëndësishme](#) si për Evropën ashtu edhe për Greqinë. Megjithatë, ai theksoi gjithashtu se, negociatat duhet të përshpejtohen “për të siguruar thelbin dhe plotësimin e kërkesave kryesore kombëtare, përkatësisht zbatimin besnik të Marrëveshjes së Prespës dhe mbrojtjen e të drejtave kombëtare dhe pro-nësore të pakicës kombëtare greke në Shqipëri”.

Mediat shqiptare raportuan dhe mirëpritën mbështetjen e Athinës për procesin e integrimit të Tiranës në BE. Megjithatë, kishte artikuj që e shihnin Greqinë me dyshim dhe këshillonin qeverinë shqiptare të kujdesej për kuadrin negociator të BE-së, sepse Greqia mund t'i shtonte atij çështje dypalëshe.

4.2. MEDIAT GREKE

Interesat kombëtare janë parësore: Deklarata e zëvendësministrit të jashtëm grek më 19 korrik, përmbledh në mënyrë të përkryer mënyrën se si mediat greke zakonisht raportojnë për perspektivat evropiane të vendeve fqinje. Shkrimet apo opinionet, theksojnë rëndësinë e anëtarësimit të tyre në BE, por zakonisht e filtrojnë këtë përmes interesave kombëtare greke.

Më 20 korrik, **Political** (e djathtë) shkroi: Varvitsiotis u kujtoi atyre (Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut) detyrimet e tyre. Me një ton tjetër, **TA NEA** (e qendrës) foli për *"Një faqe të re për Ballkanin: Athina duket e kënaqur me hapjen e bisedimeve të pranimit për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë"*. Dhe një shkrim në **Liberal** (qendra e djathtë) mbi *"Kompromisi që hapi bisedimet e pranimit të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë"*, vuri në dukje se "Greqia duhet të lidhë rrjedhën e negociatave të anëtarësimit me situatën e pakicës kombëtare greke në Shqipëri, çështjen e pronave, arsimimin dhe përfaqësimin e tyre të barabartë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit".

MEDIAT GREKE

Integrimi i Shqipërisë në BE

Αλλαγή σελίδας για τα Βαλκάνια

Ικανοποίηση στην Αθήνα για την έναρξη των ενταξιακών διαπραγματεύσεων της ΕΕ με τη Βόρεια Μακεδονία και την Αλβανία

ΤΗ ΑΛΕΞΑΝΔΡΑΣ ΦΩΤΙΑΚΗ

«Στοιχείο» για την ελληνική **δημοκρατία** έχει χαρακτηρίσει επικριτικά τον **Δημήτρη Βαλκάνιο**, θύματα, χωρίς όμως στην ανάγκη να προσεγγίσουν και να οικοδομηθούν οι διόικτες που αφορούν την έναρξη της **Βόρειας Μακεδονίας** και της **Αλβανίας** στην ΕΕ. Ένα ζήτημα που για την Αθήνα είναι φυλά στην ατζέντα, καθώς αφορά την άμεση γειτονιά της χώρας, με την Επικράτεια να θεωρείται άρκετος παράγοντας για τη διατήρηση της ασταθότητας στην περιοχή, αλλά και την αντιστάση διαίτησης και καταρροπικής αναθεωρητικών οντοτήτων.

Την έναρξη των ενταξιακών διαπραγματεύσεων της ΕΕ με τη **Βόρεια Μακεδονία** και την **Αλβανία** ανακοίνωσε χθες η κυβέρνηση της Ελληνικής Δημοκρατίας, Ουρουσσία φων ντερ Αλιέν, εκστρατεία διόικτη, με τη πρωθυπουργός των δύο χωρών Ντόμινα Κοβιταρέφσκι και Εντρί Ρόμα. Η πρωτόβρος της Κοβιταρέφσκι για μία «ιστορική στιγμή» και για ένα γεγονός που οι πολίτες των δύο χωρών περιμένουν γιο τόσο καιρό και το αξίζουν. Δείχτε «περισσότερο όραμα και ηγεσία», σημείωσε απευθυνόμενι σε Ρόμα και Κοβιταρέφσκι, ενώ τόνισε ότι απειλούν την αφοσίωση τους στις ευρωπαϊκές αξίες.

Μετά τη δικαίω μερική διάσκεψη που πραγματοποιήθηκε χθες η φων ντερ Αλιέν σημείωσε ότι η Κομισιόν και ομάδα από την Αλβανία και τη **Βόρεια Μακεδονία** «θα εργάζονται να εργάζονται». Φοιζώνισσι ο **έλεγχος του εκκαθαρώου της ΕΕ**. Αυτό είναι το τρίτο.

Ο Βορβιτσιώτης τους υπενθύμισε τις υποχρεώσεις τους

Στη Βρυξέλλες χθες πραγματοποιήθηκε η τρίτη διμερή διαπραγματευτική διασκέδαση για την έναρξη των ενταξιακών διαπραγματεύσεων της Βόρειας Μακεδονίας και της Αλβανίας. Ενώ βρέθηκε ο υποπρωθυπουργός **Δημήτριος Βορβιτσιώτης**, ο οποίος κατέταξε τις ενταξιακές διαπραγματεύσεις των χωρών των διατάξεων Βαλκανίων. Επίσης, είχε τον πρωθυπουργό της Αλβανίας. Ένα Ρόμα και τον πρωθυπουργό της Βόρειας Μακεδονίας. Αυτό που τόνισε ο π. Βορβιτσιώτης προς δύο αρμοβιογράφους είναι ότι θα σπριζεί την έναρξη τους στην ΕΕ, αρχικά, πρώτον, η Αλβανία να αξιολογήσει την ελληνική δημοκρατία στην Αλβανία, δεύτερον η Βόρεια Μακεδονία να αξιολογήσει πλήρως τη Συμφωνία των Πριςτινών. Κοινώς, υπενθύμισσε τις υποχρεώσεις τους προς την Ελλάδα.



Ο συμβιβασμός που άνοιξε τις ενταξιακές διαπραγματεύσεις Β. Μακεδονίας - Αλβανίας

Με αμφιλεγόμενα στοιχεία βυβαί μελοισχυρισμό από πολλές ιστορικές και πολιτιστικές αντιθέσεις, η Βόρεια Μακεδονία πήρε το πρώτο φως από τη Βελιγράδι ώστε η Εμπλεκόμενη η διαδικασία και να αρχίζει σήμερα και τυπικά η αναμενόμενη εδώ και χρόνια διακεκριμένη διαδικασία για την έναρξη των ενταξιακών διαπραγματεύσεων με την ΕΕ.

4.3. MEDIA SHQIPTARE

"Greqia, një mbështetëse e fortë e integritit të Shqipërisë në BE": Greqia ka qenë gjithmonë një nga mbështetëset më të forta të procesit të integritit të Shqipërisë në BE. Kjo përsëritet vazhdimisht gjatë takimeve dhe mesazheve si ai i dërguar nga Ministri i Jashtëm grek, Nikos Den-dias, gjatë vizitës së tij në Tiranë më 23 maj.


Euronews Albania (neutrale) raportoi të plotë deklaratën që ai bëri në konferencën e përbashkët me homologen e tij, Olta Xhaçka: "Greqia mbështet plotësisht fillimin e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe është absolutisht e gatshme të japë asistencë teknike".

Mesazhi i kryeministrit grek për shqiptarët për hapjen e negociatave me BE-në më 28 korrik, u mbulua fuqishëm nga mediat: *"Sot gëzojmë me ju, sepse besojmë se ju e keni merituar. Greqia si fqinji juaj i afërt, ju uron më të mirat. Urime Shqipëri!"* ([ABC News](#), pro qeveritare, [Gazeta Sot](#), opozitare).


MEDIAT SHQIPTARE

Integrimi i Shqipërisë në BE

Mitsotakis uron shqiptarët për hapjen e negociatave me BE-në: Gëzohemi për ju



Hapja e negociatave me BE-në, kryeministri grek uron shqiptarët: Urime të gjithëve për arritjet tuaja, sot gëzojmë me ju



4.4. RËNDËSIA POLITIKE

Mungon një tablo më e gjerë: Shembujt e mësipërm janë tregues se si mediat greke zakonisht raportojnë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor, edhe pse Greqia ka qenë një nga mbështetësit më të hapur për negociatat e pranimit të këtyre vendeve në BE. Mbulimi mediatik shfaq pak interes mbi përfitimet për Ballkanin Perëndimor ose për të ardhmen evropiane të rajonit. Raportimi është shpesh pozitiv, megjithëse nuk ofron një analizë të thelluar se pse rajoni duhet të ketë një të ardhme evropiane. Për më tepër, pak analiza fokusohen në përfitimet që do të sjellë përfshirja e rajonit në BE për Greqinë dhe BE-në.

Në rastin e Shqipërisë, mediat greke raportojnë në mënyrë tipike deklarata të bëra nga zyrtarët grekë, të cilat nxjerrin në pah qëndrimin grek për të drejtat e minoritetit grek. Për më tepër, media konservatore shkon deri aty, sa i kërkon Athinës të përdorë veton kundër Shqipërisë, nëse Tirana nuk do të përmbushë kërkesat ose interesat greke, të cilat përfshijnë çështjen e kufijve detarë ose marrëdhëniet e supozuara si të ngushta, të Shqipërisë me Turqinë. Në përgjithësi, mediat greke humbasin mundësinë për të vënë në pah përfitimet e shumta që mund të sjellë një Shqipëri evropiane, si për vetë vendin, ashtu edhe për marrëdhëniet e popullit shqiptar me fqinjët e tyre në rajon.

Nga ana e tyre, mediat shqiptare nuk arrijnë të përfitojnë nga dy mundësi të rëndësishme: së pari, të informojnë publikun shqiptar se Greqia është një avokate e fortë e së ardhmes evropiane të Shqipërisë, gjë që është e dukshme nga sondazhet ku publiku shqiptar është i pavetëdijsëm për këtë në një masë të konsiderueshme; dhe së dyti, për të reflektuar se çfarë do të thotë integrimi evropian i Shqipërisë për marrëdhëniet aktuale mes dy vendeve dhe mundësitë që do të krijonte për bashkëpunim.



4.5. KONKLUZIONE KRYESORE

- ↳ Greqia dhe Shqipëria janë në unitet të plotë rreth orientimit të tyre gjeopolitik dhe atë të rajonit. Greqia është gjithashtu një mbështetëse e fortë e anëtarësimit në BE për Shqipërinë dhe për të gjithë Ballkanin Perëndimor.
- ↳ Ky linjëzim ofron një mundësi të shkëlqyer për të dy vendet, që të bazojnë partneritetin e tyre të ardhshëm në themelet solide të integritit evropian.
- ↳ Ndërkohë, mbulimi mediatik mbetet i vogël në perspektivë nga të dyja palët dhe kryesisht fokusohet në interesin kombëtar. Ai dështon të raportojë dhe/ose analizojë përfitimet që pritet të sjellë integrimi evropian për shoqërinë shqiptare, marrëdhëniet dypalëshe dhe Ballkanin Perëndimor në tërësi.
- ↳ Kjo reflektohet në opinionin publik, ku qëndrimet janë më të paqarta sesa vizioni aktual i përbashkët i anëtarësimit në BE.

5. ÇËSHTJA

Historia e suksesit të Elina Tzengko

Shoqëria tregon rrugën:



5.1. HISTORIK I SHKURTËR

Elina Tzengko, kampionia evropiane e shtizës, e lindur dhe e rritur në Greqi nga prindër emigrantë shqiptarë, fitoi medaljen e artë në Kampionatin Evropian në Mynih më 18 gusht.

5.2. MEDIAT GREKE

"Një histori suksesi": Fillimisht, mediat greke e përqufuan ngrohtësisht fitoren e Tzengkos, por nuk arritën të raportnin për përkatësinë etnike të familjes së saj. Uebfaqet e lajmeve (**naftemporiki.gr**, **paron.gr**, **cnn.gr**) dhe gazetatat sportive, e quajtën atë: "kampionë e artë", "mbretëresha e Evropës".

Por pasi Elina Tzengko foli për vuajtjet me të cilat përballej ajo personalisht dhe familja e saj dhe për vështirësitë që kishin hasur në marrjen e nënshtetësisë greke, duke u bërë jehonë përvojave të shumë fëmijëve të lindur nga emigrantë, tregimet mediatike filluan ta nxirrnin në pah këtë problem të pazgjidhur. [Intervista](#) e saj në **atletstories.gr** u riprodhua në shkrime të tjera nëpër faqe interneti, ndërsa citate nga historia e saj personale, u shfaqën në media të shumta.

Disa raportime mediatike e përshkruan marrjen e nënshtetësisë greke nga Tzengko, si një "odisë" personale, ndërkohë që e detyruan të humbiste ngjarjet ndërkombëtare, në të cilat ajo nuk kishte të drejtë të merrte pjesë, deri në vitin 2018, kur iu dha shtetësia greke. Siç ka treguar në intervistën e saj, ky ishte një proces i gjatë dhe i dhembshëm psikologjikisht.

Më 26 gusht, gazeta **Avgi** botoi një artikull me titull *"Nëse nuk bëhesh kampion, nuk bëhesh kurrë grek"* që përmban [një punë kërkimore](#) të Generation 2.0, i cili zbulon se si disa fëmijë emigrantësh nuk e patën të lehtë të merrnin shtetësinë greke, sepse ky është një privilegj që e gëzojnë vetëm atletë të mirë si Tzengko.

MEDIAT GREKE

Historia e suksesit të Elina Tzengko



Ελίνα Τζένγκο: ο «αγώνας» για την ελληνική ιθαγένεια πριν τον αγώνα για την Ελλάδα

Photo: 24/08/2022 / Source: Twitter | Δημόσιος, Ελλάδα/Elina Tsengou, 17/08/2022 21:00





5.3. MEDIAT SHQIPTARE

"Edhe një tjetër histori sukseasi shqiptare": Shumica e mediave raportuan fitoren e Tzengkos, duke përdorur fjalën 'Shqiptarja'. [Gazeta Dita](#): "Një tjetër shqiptare shpallet kampione e Evropës me flamurin grek". Shqiptarja.com: "Pas Luiza Gegës, një tjetër shqiptare shpallet kampione Evrope, por me flamur tjetër". E njëjta gazetë raportoi se, Tzengko, nuk foli më për rrënjët e saj shqiptare pas fitores së saj, gjë që dukshëm është e pavërtetë.

Mediat shqiptare raportuan gjithashtu detaje për jetën dhe familjen e Tzengkos, prindërit e saj punëtorë, luftën e saj të gjatë burokratike për të marrë nënshtetësinë greke, edhe pse ajo kishte lindur në Greqi. [Koha Jonë](#) raportoi historinë e nënës së saj, duke u fokusuar në [mesazhe negative](#) që ajo kishte marrë: "Kampione Evrope për Greqinë, shqiptarja Elina Xhengo: Mora mesazhe negative nga grekët". [Gazeta Panorama](#) përdori një [titull karrem](#): "Një 19-vjeçare shqiptare fiton medaljen e artë në Evropianin e Atletikës... për Greqinë".

MEDIAT SHQIPTARE

Historia e suksesit të Elina Tzengko



5.4. RËNDËSIA POLITIKE

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut: Historia e Elina Tzengkos, është e rëndësishme, sepse historitë sociale për shqiptarët që jetojnë në Greqi, raportohen gjerësisht nga mediat në të dy vendet, por shumë shpesh janë të lidhura me krimin. Kjo ka një ndikim të konsiderueshëm negativ, pasi riprodhon stereotipe negative për komunitetin e emigrantëve shqiptarë në Greqi, i cili është pothuajse i integruar plotësisht dhe me sukses në shoqërinë greke. Përqendrimi në histori pozitive, ndihmon për të përmirësuar gjendjen aktuale të shumicës dërrmuese të njerëzve me origjinë shqiptare që jetojnë në Greqi. Të kuptuarit e gjendjes së tyre të vështirë dhe të harresës ligjore, do të ndihmonte gjithashtu në ndërtimin e marrëdhënieve të besimit midis dy shoqërive.

Me apo pa qëllim, mediat greke nuk u fokusuan fillimisht tek origjina e Tzengkos. Ajo përfaqësoonte Greqinë në kampionat dhe medalja e saj u festua, pa hamendje të dytë, si një fitore greke. Megjithatë, pas zbulimeve të saj për vështirësitë që hasi në marrjen e nënshtetësisë greke, shumica e mediave greke, u përqendruan te problemi që ndajnë edhe shumë fëmijë të tjerë të emigrantëve: domethënë se ata nuk gëzojnë të drejta të barabarta me bashkëmoshatarët e tyre grekë kur mbushin 18 vjeç.

Këto histori rrisin ndërgjegjësimin e publikut jo vetëm për problemet burokratike që duhet të zgjidhen më në fund, por edhe për mënyrat e shumta me të cilat emigrantët dhe familjet e tyre kanë pasuruar shoqërinë greke. Interesi dhe ngrohtësia që historia e Tzengkos krijoi në publikun grek, tregon se sa i pranuar është integrimi i emigrantëve shqiptarë në shoqërinë greke në ditët e sotme.


Edhe në Shqipëri, shumica e komenteve të mediave, ishin pozitive dhe respektuese për sukse-


sin e saj si një qytetare e re greke. Megjithatë, ka pasur raste ku mediat zgjodhën të prodhonin lajme për klikime ose për të ushqyer audiencën e tyre me tituj nacionalistë. Megjithatë, shumica e shkrimeve pasqyronin perceptimin e përgjithshëm të publikut në Shqipëri, se shqiptarët janë integruar mirë në shoqërinë greke.




SONDAZH I OPINIONIT PUBLIK:
OSFA/ELIAMEP, 2021
Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë

Mbi migrantët shqiptarë dhe integrimin e tyre në Greqi

 Gjithë të anketuarit shqiptarë mendojnë se imigrantët shqiptarë kanë kontribuar si në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë ashtu dhe të Greqisë.


 Shumica dërmuese e të anketuarve grekë mbështesin idenë se imigrantët shqiptarë nuk përbëjnë rrezik për Greqinë (74%).

 Po ashtu, 97% e opinionit publik shqiptar është dakord se migrantët shqiptarë nuk përbëjnë rrezik.

5.5. KONKLUZIONE KRYESORE

- ↳ Pavarësisht nga e kaluara e turbullt dhe pengesat e shumta ligjore dhe administrative, shqiptarët paraqesin një shembull të shkëlqyer të një komuniteti emigrant shumë të integruar, i cili ka kontribuar në zhvillimin ekonomik të Greqisë dhe ka pasuruar shoqërinë greke kulturalisht.
- ↳ Por mediat në të dy vendet, vazhdojnë të përqendrohen më shumë në incidente që minimizojnë rëndësinë e kësaj “ure njerëzore” midis dy shoqërive, ndërkohë që narrativat e tyre vazhdojnë të riprodhojnë paragjykimet dhe stereotipet negative që dy shoqëritë kanë për njëra-tjetrën.
- ↳ Histori si ajo e Elina Tzengkos dhe shumë të tjera si ajo, kanë nevojë për më shumë vëmendje mediatike, nëse duam që situata aktuale shoqërore të përfaqësohet më me vërtetësi dhe të rritet mirëkuptimi dhe besimi i ndërsjellë midis dy shoqërive. Mesazhe të tilla, do të përcillnin gjithashtu një përgjigje domethënëse ndaj trajtimeve raciste dhe stereotipike të migracionit nga disa media greke.

TË ANKETUARIT SHQIPTARË



2% të tjerë nuk e dinë / nuk përgjigjen

Fëmijët e migrantëve shqiptarë që janë rritur në Greqi janë plotësisht të integruar në shoqërinë greke.

TË ANKETUARIT GREKË



1% të tjerë nuk e dinë / nuk përgjigjen

Ekipi

Drejtuues i projektit dhe koordinator akademik:

[Ioannis Armakolas](#)

Profesor i Asociuar, Universiteti i Maqedonisë; Bashkëpunëtor Shkencor & Shef i Programit të Evropës Juglindore, ELIAMEP

Analiste e medias & kryeredaktore e MORE:

[Alexandra Voudouri](#)

Studiuese e Asociuar, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Analist i medias dhe redaktor i MORE:

[Çelik Rrupli](#)

Studiues i Asociuar, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Asistent kërkimor dhe redaktimi:

[Ioannis Paporizos](#)

Junior Research Fellow, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Administrator:

[Alexandros Koutras](#)

Junior Research Fellow, Project Manager, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Rreth këtij publikimi

Shënim i rëndësishëm: Të gjithë "artikujt e medias - imazhet" dhe lidhjet e përfshira në këtë Raport të Observatorit të Medias (MORE shkurt. 2023) janë indikative dhe përdoren ekskluzivisht si shembuj për hir të ekuilibrit dhe si dëshmi e gjetjeve dhe vlerësimeve tona cilësore kërkimore. Si projekt, MORE, nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë si komercial. Përdorimi i paanshëm i artikujve të medias dhe lidhjeve ishte qëllimi ynë ekskluziv si analistë politikë në një organizatë jofitimprurëse.

Raporti i Observatorit të Medias (MORE) është pjesë e projektit shumëstresor **ALGREE — Shqipëri-Greqi: Kuptimi. Lidhja. Partneriteti.** zbatuar nga Programi i Evropës Juglindore të Fondacionit helen për Politikën e Jashtme dhe Evropiane (ELIAMEP), dhe i mundësuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ([OSFA](#)) dhe Fondacioni Friedrich Naumann për Liri Greqi dhe Qipro ([FNF](#)).

Rreth [Programit Juglindor të ELIAMEP-it](#)

Rreth projektit [ALGREE — Shqipëri-Greqi: Kuptimi. Lidhja. Partneriteti.](#)

Rreth [Shih MORE – Raporti i Observatorit të Medias](#)

Email: algree_see@eliamep.gr

Na ndiqni në mediet sociale:

 facebook: [South-East Europe Programme/ ELIAMEP](#)

 twitter: [SEE Programme ELIAMEP](#)

Copyright © 2023 | All Rights Reserved
HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN AND FOREIGN POLICY (ELIAMEP)

*ELIAMEP inkurajon dialogun e hapur dhe, pluralist të bazuar në argumente dhe fakte.
Pikëpamjet e shprehura nga bashkëpunëtorët e ELIAMEP-it janë tërësisht të tyre dhe nuk janë të detyrueshme për Institucionin.*

ZBATUAR NGA

MUNDËSUAR NGA

eDizajni kreativ**Marie Claire I. Androulaki**PR/Marketing Communications Consultant
& Creative eDesigner, MAKES SENSE

M	A	K	E	S
S	E	N	S	E

Ilustrimet/Të drejtat e fotove & E drejta e autorit- Leja për përdorim

Ilustrimet/Të drejtat e fotove nga bankat e imazheve dhe platformat kreative: ©Dreamstime.com,** ©Envato elements,** ©Canva**

Çdo artikull (ilustrim, foto) i përfshirë në këtë raport nuk duhet të nxirret apo përdoret veçmas nga ky produkt fundor. Këta artikuj nuk janë pronësi e ELIAMEP or MAKES SENSE.as ELIAMEP apo MAKES SENSE nuk ka të drejtë autori lidhur me logot, ilustrimet dhe fotot e palëve të treta nga bankat e imazheve apo platformat (siç u përmend më lart) që shfaqen në të gjitha faqet –*përveç kopertinës dhe ilustrimit të faqeve (në tërësi) dhe gjithë grafikët statistikorë – të dhënat në faqet 13,19, 34.* Për çdo përdorim apo riprodhim të elementëve që nuk janë në pronësi të ELIAMEP apo MAKES SENSE, nevojitet leje-licencë që duhet kërkuar drejtpërdrejt nga mbajtësit përkatës të të drejtave.

** Përpunime/rregullime të mëtejshme, përshtatja ose dizajni kreativ i ilustrimeve - fotove nga MAKES SENSE



ΕΛΙΑΜΕΠ
ELIAMEP

ΕΛΛΗΝΙΚΟ ΙΔΡΥΜΑ ΕΥΡΩΠΑΪΚΗΣ & ΕΞΩΤΕΡΙΚΗΣ ΠΟΛΙΤΙΚΗΣ
HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN & FOREIGN POLICY

Copyright © 2023 | All Rights Reserved

**HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN
AND FOREIGN POLICY (ELIAMEP)**

49, Vasilissis Sofias Ave.
10676 Athinë, Greqi
Tel: +30 210 7257 110

[Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP](#)

Projekti [ALGREE — Shqipëri-Greqi: Kuptimi. Lidhja. Partneriteti.](#)
algree_see@eliamep.gr

 [South-East Europe Programme/ ELIAMEP](#)



[SEE Programme ELIAMEP](#)

#ALGREE